

Hapet thirrja për bursa studimi për studentët e UMT, në Universitetin e Letonisë në Letoni, në kuadër të programit Erasmus +.

Mobiliteti dhe kohëzgjatja e bursave:

Studentët do të studiojnë semestrin e dytë të vitit akademik 2022-2023 në Universitetin e Letonisë në Letoni.

Kush mund të aplikojë:

Studentët e UMT-së të cilët gjatë vitit akademik 2022-2023 do të jenë në vitin e dytë dhe të tretë bachelor si dhe studentë të vitit të parë dhe të dytë të masterit nga Fakulteti:

-Fakulteti i Ekonomisë

Lëndët të cilat zhvillohen në anglisht në universitetin pritës në semestrin e dytë i gjeni duke klikuar në linkun <https://www.lu.lv/en/gribustudet/arzemju-studentiem-eng/exchange/courses/bmef/>

Gjuha e mësimdhënies:

Mësimdhënia do të jetë në gjuhën angleze.

Bursat përfshijnë:

- Kompensimin mujor për studentët (800 EUR në muaj);

Për të përcaktuar distancën ju lutemi referohuni në këtë link:

http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm

Dokumentat e nevojshme për aplikim:

- Vërtetim dhe Listë notash e ciklit aktual të studimit;
- Kopje e pasaportës;
- Fotokopje e Certifikatës/dëshmi e gjuhës angleze ose dokument që vërteton njohuritë në këtë gjuhë. Niveli i kërkuar minimalisht B1; Nqs mungon certifikata e njohur ndërkombëtarisht atëherë pajisuni me një certifikatë nga lektori i gjuhës angleze në UMT.
- Dokumenti Learning Agreement*



** Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë “Before the mobility. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihen në Universitetin Metropolitan Tirana kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Universitetin e Letonisë në Letoni lëndë të njëjta me ato që do të kryenit në semestrin e dytë të vitit akademik 2022/2023 në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillonit në fakultetin tuaj, atëherë kur të ktheheni duhet të jepni provim lëndët që nuk përshtaten në Universitetin Metropolitan Tirana.

Dokumenti “Learning Agreement” tek seksioni “Commitment” firmoset nga aplikanti dhe më pas në seksionin “sending university” firmoset nga Përgjegjësi i Departamentit në UMT.

Për të shkarkuar formatin e Learning Agreement klikoni në adresën: https://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/resources/documents/learning-agreement-student-mobility-studies-docx_en

Afati për aplikim: 02 Dhjetor, 2022.

Për të aplikuar ju lutemi të dorëzoni dokumentet të skanuara me e-mail në adresën iroprojects@umt.eu.al ose dorazi në Drejtorinë e Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë në Universitetin Metropolitan Tirana.

UMT ju uron shumë suksese në aplikimin tuaj!